

# Hunda e zënë : larja në rast ftohjeje



Fëmija juaj mund të jetë i ftohur dhe të ketë vështirësi për të marrë frymë, sepse hunda e tij është e zënë me sekrecione.

Duke marrë frymë kryesisht me hundë, foshnja juaj mund të ketë vështirësi të ushqehet. Për këtë arsye larja e hundës bëhet para ngrënies.

## Si të veprohet në shtëpi

- Hunda është e ndjeshme dhe delikate te foshnja, gjestet e mëposhtme duhet të bëhen me shumë butësi
- Përgatitni një shishe me serum fiziologjik minimumi 5 ml
- Shtrijeni fëmijën tuaj anash
- Vendoseni fundin e përshtatshëm të shishes në vrimën e sipërme të hundës
- Zbrazni me kujdes gjysmën e lëngut në vrimë të hundës. Lëngu do të dalë bashkë me sekrecione nga vrima tjetër e hundës ose do të kalojë në fyt.
- Uleni fëmijën tuaj që të mund të marrë frymë
- Kthejeni fëmijën në anën tjetër dhe bëni të njëjtën gjë me vrimën tjetër të hundës

## E rëndësishme

- Ky veprimj duhet të bëhet me butësi
- Është e nevojshme që ta mbani mirë fëmijën gjatë trajtimit për të shmangur dëmtimin e tij
- Nuk këshillohet përdorimi i aspiratorit të hundës për bebe, por nëse dëshironi ta përdorni, konsultohuni me pediatri tuaj. Nëse frymëmarrja e fëmijës suaj nuk përmirësohet, konsultoni një profesionist për fëmijë të vegjël



Programme cantonal de promotion de la santé et de prévention primaire enfants (0-4 ans) - parents



Section VD Ne Ju  
Fédération Suisse de Sages-femmes

